



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Tiranë

Tel. 04 2268142; Fax 04 2268141

Nr. 428/11 Prot

Tiranë më 30.12.2016

**V E N D I M**

**Nr. 175, datë 30.12.2016**

**Mbi rifillimin e hetimit administrativ, të pezulluar me vendimin nr. 84, dt. 21.07.2016 "Mbi pezullimin e procesit të verifikimit të procedurës së ngritjes në detyrë, për pozicionin "Specialist në Sektorin e Hartografimit", në Drejtorinë e Gjeologjisë"**

Me urdhrin nr. 428/1, datë 20.06.2016, Komisioneri për Mbikëqytjen e Shërbimit Civil, ka filluar verifikimin e procedurës së konkurrimit nëpërmjet ngritjes në detyrë, për pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Hartografimit", në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar.

Në vijim, me shkresën nr. 428/6 prot., dt. 07.07.2016, "Kthim Përgjigje", Departamenti i Administratës Publike ka informuar Komisionerin, se pranë këtij institucioni është depozituar një ankesë nga nëpunësi civil \*\*\*\*\* , në të cilën parashtrohet se ky i fundit gjendet në kushtet e konfliktit të interesit me dy prej anëtarëve të Komitetit të Pranimit për ngritje në detyrë (\*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*), për pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Hartografimit, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar".

Duke vlerësuar se pretendimet e ngritura, kanë krijuar dyshime të arsyeshme për mundësinë e ekzistencës së konfliktit të interesit, Departamenti i Administratës Publike, me vendimin nr. 3013, dt. 09.06.2016, ka vendosur të pezullojë zhvillimin e mëtejshëm të procedurës së konkurrimit duke nisur një hetim administrativ për verifikimin e këtij rasti.

Për këtë arsye, Komisioneri për Mbikëqytjen e Shërbimit Civil, bazuar në nenin 66 pika 1 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të RSH", me vendimin nr. 84, datë 21.07.2016, ka vendosur pezullimin e procesit të verifikimit, deri në përfundimin e procedurës së hetimit administrativ nga ana e Departamentit të Administratës Publike.

Me aktin nr. 399/10 prot., datë 25.11.2016, Departamenti i Administratës Publike ka njoftuar Komisionerin për Mbikëqytjen e Shërbimit Civil për vendimmarrjen përfundimtare, lidhur me përfundimin e hetimit administrativ për procedurën e ngritjes në detyrë për pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Hartografimit, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar".

Në kushtet kur, shkakun për të cilin është marrë masa e pezullimit nëpërmjet vendimit nr. 84, datë 21.07.2016 të Komisionerit "Për pezullimin e procesit të verifikimit të procedurës së ngritjes në detyrë, për pozicionin "Specialist në Sektorin e Hartografimit", në Drejtorinë e Gjeologjisë, pranë

*Shërbimit Gjeologjik Shqiptar*” ka rënë, në bazë të nenit 68 pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të RSH*”, ka vend për rifillimin e hetimit administrativ.

**Për këto arsye,**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në pikën 1, të nenit 11 dhe nenit 14, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, bazuar në nenin 68 pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të RSH*” dhe Rregulloren “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

**V E N D O S A:**

1. Të rifillojë hetimi administrativ, i pezulluar me vendimin nr. 84, dt. 21.07.2016 “*Për pezullimin e procesit të verifikimit të procedurës së ngritjes në detyrë, për pozicionin “Specialist në Sektorin e Hartografimit*”, në Drejtorinë e Gjeologjisë, pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar” dhe vazhdimin e hetimit administrativ.
2. Të përgatitet relacioni përkatës dhe t’i paraqitet Drejtorit të Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, brenda datës **10.01.2017**.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**